

VENDIM
Nr.69, datë 17.2.2010

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.1070, DATË 21.10.2009 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT DHE TË
TARIFAVE TË SHKOLLIMIT NË PROGRAMET E STUDIMEVE “MASTER I
NIVELIT TË DYTË”, NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, PËR
VITIN AKADEMIK**

**2009 – 2010, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.829, DATË 29.7.2009
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMEVE
“MASTER I NIVELIT TË DYTË” NË FAKULTETIN E MUZIKËS TË AKADEMISË
SË ARTEVE, DHE MIRATIMIN E KUOTAVE DHE TË TARIFAVE PËR KËTO
PROGRAME”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 34 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.1070, datë 21.10.2009 të Këshillit të Ministrave, pas pikës 2 shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:
“2/1. Kuotat e paplotësuara rishpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.”.
2. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha